VENDIM
Nr. 122, datë 13.3.2019

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE E POSTARE, PËR VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP), për vitin 2019, në shumën 378 360 000 (treqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PASQYRA NR. 1
PLANI I SHPENZIMEVE TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE E POSTARE PËR VITIN 2019

Të ardhura	**Në mijë lekë**	**Shpenzime**	**Në mijë lekë**
Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike	160 000	Shpenzime personeli	114 049
Të ardhura nga pagesa për frekuencat	132 000	Shpenzime për sigurimet shoqërore e shëndetësore	14 751
Të ardhura nga pagesa për numeracionin	26 000	Shpenzime për materiale	8 730
Të ardhura nga pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	20 160	Shpenzime për shërbime	148 914
Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar	8 500	Shpenzime për investime	91 916
Të ardhura nga pagesa për domain	8 000		
Të ardhura nga pagesa të tjera	700		
Të ardhura nga agjenti tatimor	23 000		
Total i të ardhurave	**378 360**	**Totali i shpenzimeve**	**378 360**